

OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR NË KIMI

Programi Bachelor në Kimi synon që:

1. studentët të kenë plotësuar profilin kulturor me njohuri të përgjithshme në fushën e kimisë inorganike, analitike, organike, kimisë fizike, strukturës së lëndës dhe metodave instrumentale të analizës.
2. studentët të fitojnë një sërë njohurish praktike nëpërmjet seanceve laboratorike
3. studentët të përfitojnë njohuri mbi përpunimin e informacionit, shkrimin akademik si dhe aftësi të prezantimit të dijeve të tyre në publik
4. studentët të jenë të aftë të përzgjedhin, përpunojnë dhe analizojnë mostra të ndryshme dhe komplekse me origjinë organike dhe inorganike
5. studentët të jenë të aftë të përdorin mjete dhe aparatura bazë të një laboratorimi kimik
6. studentët të përgatiten si specialistë kimistë, të aftë profesionalisht që t'i përgjigjen nivelit bashkëkohor të zhvillimit.
7. studentët të aftësohen për t'u përballur me tregun aktual të punës në vend, si të punësuar: pranë laboratoreve të analizës kimike, pranë laboratoreve të kërkimit kimik, pranë laboratoreve të doganave e kompanive prodhuese në vend, në linjat prodhuese të industrisë kimike, në linjat prodhuese të ndërmarrjeve ushqimore, pranë drejtorisë së akreditimit të laboratoreve, si specialistë në qendra rajonale kombëtare të mjedisit, etj